

REZOLUTË PËR RITJEN E PAGËS MINIMALE

Drejtuar:

- **Kuvendit të Republikës së Shqipërisë**
- **Qeverisë së Republikës së Shqipërisë**
- **Z. Edi Rama, Kryeministër**

Asambleja e Përgjithshme e KSSH dhe të gjithë strukturat drejtuese të saj, të mbledhura me datë 11.11.2016 në Konferencën Kombëtare **“Efektet e Rritjes së Pagës Minimale në Ekonominë Shqiptare”** pasi diskutuan për ndikimet e pagës minimale në ekonominë shqiptare mbështetur në studimet dhe hulumtimet e kryera në mënyrë shkencore dhe me profesionalizëm në bashkëpunim me qarqe akademike dhe shoqërinë civile vendosi që ti drejtohet Qeverisë Shqiptare me një kërkesë të posaçme: **“Rritjen urgjente të pagës minimale në masën 30-50 % sipas profesioneve”**.

Strukturat drejtuese dhe vendimmarrëse të KSSH mendojnë se paga është një komponent i rëndësishëm jo vetëm si burim financiar por ajo merr një rëndësi të veçantë si një element i rëndësishëm në menaxhimin e aseteve dhe të kapitalit human, pasi në fund të fundit kjo është arsyeja se përse punohet.

Që nga korriku i vitit 2013 në Shqipëri nuk ka patur rritje të pagës minimale aktualisht kjo është 22000 lek në muaj (156 euro) dhe paguhet për 174 orë punë në muaj të kryer në kohën normale të punës. Paga minimale orare është 129 lek/orë pune. Kjo pagë është më e ulëta në të gjithë rajonin e Ballkanit. Ne konstatojmë se kjo pagë minimale është nën “normat e tregut” dhe si e tillë ajo tashmë ka krijuar pakënaqësi, demotivim dhe shpesh kundërshti e konflikte sociale duke i rënduar ekuilibret sociale, prandaj ne ju sjellim në vëmendje nenin 4 të Kartës Sociale Europiane që thekson: **“nuk konsiderohet në përputhje me kartën në se paga minimale zbret nën 60 % të pagës mesatare neto kombëtare”**. Kërkesa jonë për rritje të menjëhershme dhe të ndjeshme të pagës minimale merr parasysh plotësimin minimal të nevojave themelore të punonjësve si dhe Konventën nr. 26 të ILO **“Mekanizmi i caktimit të pagës minimale”**, ratifikuar nga vendi ynë që me 23.04.2001.

KSSH si sindikata më e përfaqësuar në Shqipëri vazhdimisht e ka konsideruar pagën minimale dhe minimumin jetik jo si një abstraksion ekonomik por si një burim jetësor i domosdoshëm për punëtorët. Kërkesa jonë dhe realizimi i saj janë një hap i rëndësishëm i hedhur në drejtim të arritjes së standardeve minimalisht të pranueshme për një pagë dhe një shpërblim dinjitoz. Kjo kërkesë jo vetëm që do ju shërbejë punëmarrësve por ajo ka dhe një arsyetim dhe logjikë ekonomike pasi do të rivlerësojë çmimin e krahut të punës, do të rirregullojë sistemin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, do të rrisi konsumin dhe do të nxisi një rritje ekonomike reale.

Konferenca e sotme dhe studimi që ajo promovoj e vërtetojnë më se miri logjikën ekonomike dhe bazueshmërinë ligjore të kërkesës tonë. Kërkesa jonë argumentohet plotësisht në treguesit e përgjithshëm ekonomik e kryesisht në kërkesat e zhvillimit ekonomik, në minimizimin e papunësisë, rritjen e prodhimit dhe më kryesorja për ne sindikatat në nevojat e punonjësve dhe të familjeve të tyre për të ruajtur nivelet e standardet e jetesës.

Studimi ynë vërtetoi qartë se kërkesa jonë ka bazueshmëri dhe logjikë ekonomike e cila lidhet me aftësitë konkurruese të ekonomisë tonë. Kjo kërkesë merr parasysh edhe ndryshimin e

dinamikës së përgjithshme të pagave që pësohet nga kjo rritje, normën e inflacionit nga njëri vit në tjetrin si dhe aftësitë e buxhetit të shtetit për të përballuar këtë rritje (për punonjësit buxhetor) si dhe me aftësitë konkurruese e paguese të bizneseve vendase e të huaja që operojnë në Shqipëri në sektorin privat.

Rritja e pagës minimale bëhet e domosdoshme jo vetëm për të rirregulluar shpërndarjen e produktit në të gjithë piramidën e sistemit të pagave por ajo nxit rritjen e pensioneve, favorizon punësimin, rrit ndihmën ekonomike, pagesat e paaftësisë e të tjera përfitime bazike të cilat fatkeqësisht në mënyrë të frikshme po rritin nivelin e varfërisë në shtrirje dhe në thellësi.

KSSH është e mendimit se tashmë është koha më e favorshme për të realizuar rekomandimet e BE dhe të ILO: ***“Për përmirësimin e pagës reale dhe rritjen e pagës minimale, mbështetjen e pagës tek produktiviteti, reforma rregullatore në paga dhe taksa, zhvillimin e dialogut social më efektiv për adaptimin më të mirë të politikave të pagave me krizat apo konfliktet sociale”***.

Kjo rritje e arsyetuar e pagës minimale është edhe në favor të trendit pozitiv të zhvillimit të reformave të ndërmarra nga Qeveria për luftën ndaj informalitetit e evazionit fiskal dhe rritjen e produktivitetit në ekonomi. Kjo do të minimizojë përpjekjet e punëdhënësve për mosdeklarimin e pagave ose nivelin e tyre.

Si përfundim krahas konkluzioneve mjaft të rëndësishme që ky studim udhëzon dhe që ato u miratuan sot në këtë Konferencë, KSSH mendon se rivlerësimi dhe rritja e pagës minimale në mënyrë ritmike institucionalizon dhe krijon lehtësira për bisedime e negociata kolektive ndërmjet sindikatave dhe punëdhënësve në mënyrë reale e transparente.

Kjo rritje e pagës minimale jep direkt efekte pozitive në uljen e varfërisë monetare duke rritur të ardhurat e për rrjedhojë duke rritur edhe konsumin. Nëpërmjet uljes së varfërisë monetare do të kemi një vlerësim real të krahut të punës, do të kemi rritje të produktivitetit të punës dukë e bërë punën dinjitoze e nëpërmjet saj duke kontribuar direkt në shëndetin e njerëzve, edukimin, arsimimin, përfshirjen sociale, punësimin, sigurinë dhe garantimin e lirisë dhe të shprehjes për përfaqësuesit e punëtorëve, për ne sindikatat.

Asambleja Kombëtare e KSSH
Presidenti
Kol Nikollaj

Tiranë, me 11.11.2016